



pranohet administrimi i Vendimit Gjyqësor nr.1178 Akti, datë 20.04.2010, urdhër ekzekutimit, në dosjen e pensionit me nr.4558.

Qëndrimi i mbajtur deri më sot prej Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, ndaj ankuesit H.M., për mosdorëzimin e aktit, vendimit, të kërkuar prej tij, vlerësohet tërësisht i parregullt, dhe pengues për subjektin ankues në materializimin e të drejtave të fituar nga ana e tij në rrugë gjyqësore, sipas Vendimit Gjyqësor nr.2076, datë 17.03.2009, të dhënë prej Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

Sikurse dihet, veprimtaria e administratës publike, pjesë e së cilës është dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me Kushtetutë e Republikës së Shqipërisë, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të drejtat apo interesat e ligjshme të një pale nuk mund cënohen nga veprimi apo mosveprimi administrativ i organit që ju përfaqësoni. Qëndrimin e Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, nuk e gjejmë në përputhje me parimin e dhënies së ndihmës aktive palëve apo personave të tjerë, me të cilat hynë në marrëdhënie Drejtoria juaj, sikurse parashikuar në nenin 10 të Kodit të Procedurës Administrative.

Ju si organ, nuk keni siguruar dhe nuk siguroni palën ankuese përsa i përket përkeqësimit në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që kjo palë gëzon sipas ligjit. Mbajtja dhe mosdorëzimi nga ana juaj i kopjes origjinale të aktit, vendimit gjyqësor të lartpërmendur, ka cënuar dhe cënon parimet mbi të cilat funksionon administrata publike, duke sjell me këtë rast dhe pamundësinë e ankuesin për kërkimin e zhvillimit të procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor nr.2076, datë 17.03.2009, dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë.

Për arsyet e bërë të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

## **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave për dorëzimin sa më parë të kopjes origjinale të urdhërit të ekzekutimit, Vendimit Gjyqësor nr.1178 Akti, datë 20.04.2010 lëshuar prej Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr.2076, datë 17.03.2009, dhënë po nga kjo Gjykatë*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Me besim në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**  
**Arben SHKEMBI**

**Konceptoi dhe Daktilografoi**  
**A.Gjoleka**